

## **Raport për rezultatet e konsultimeve publike**

### **1. Titulli i projekt aktit**

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025-2027”.

### **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike sipas parashikimeve të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Planit të Saj të Veprimit 2025-2027” si dhe relacioni përkatës u publikuan në linkun, [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al), në datë 29.5.2025 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: (1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; 3) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë) ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik [info@aksk.gov.al](mailto:info@aksk.gov.al).

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 26.6.2025.

Projektvendimi pati 813 shikime në RENJKP, por nuk pati komente të regjistruara.

### **3. Metoda e konsultimit**

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Projektvendimi i është nënshtruar vetëm procesit të konsultimit publik, nëpërmjet publikimit të tij në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data 29.5.2025 deri në datën 26.6.2025 dhe me e-mail në adresën zyrtare të koordinatorit për konsultimin publik: [info@aksk.gov.al](mailto:info@aksk.gov.al).

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Projektvendimi është propozuar nga Kryeministri dhe është hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Shërbimi Informativ i Shtetit;
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Gjatë periudhës së konsultimit publik institucionet të cilat kanë përcjellë komente dhe sugjerime (elektronikisht) janë:

- ELTA;
- Organizata e OKB-së mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women)

#### **1.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

<b>Çështja e adresuar</b>	<b>Komenti</b>	<b>Palët e interesuar</b>	<b>Vendimi</b>	<b>Justifikimi</b>
<p><b>I. Trajtim i në mënyrë efektive i sfidave që gratë dhe vajzat hasin në fushën e sigurisë kibernetike</b></p>	<p>Sugjerojmë që drafri të përfshijë sfidat kryesore të pabarazisë gjinore të identifikuar dhe të diskutuara me detaje në Udhëzimin e sipërpërmendur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Akses dhe përdorim i pabarabartë i teknologjive digjitale ndër gratë/vajzat dhe burrat/djemtë.</li> <li>• Ndarja gjinore në fushat e studimit – vajzat kanë më pak gjasa të ndjekin studime në fushat që lidhen me teknologjinë (STEM, TIK) krahasuar me djemtë.</li> <li>• Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun digjital të punës – numri i grave që fitojnë jetesën dhe bëjnë karrierë në TIK është më i vogël.</li> <li>• Dhuna ndaj grave, bullizmi dhe ngacmimi në internet, si dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore pengojnë</li> </ul>	<p>Organizata e OKB-së mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women)</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Reflektuar</p>

	<p>pjesëmarrjen e grave dhe vajzave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përforcimi i roleve të pabarabarta gjinore dhe promovimi i normave të dëmshme gjinore në internet.</li> <li>• Mungesat në të dhënat administrative e statistikave gjinore dhe të dhënave të ndara sipas seksit, si dhe mungesa e koordinimit ndërinstytucional për përcaktimin e treguesve gjinorë kryesorë.</li> </ul>			
	<p><u>Masat/Aktivitetet që adresojnë sfidat kryesore të identifikuar</u></p> <p>Më poshtë paraqiten disa shembuj të aktiviteteve që do të adresonin çështjet kryesore të pabarazisë gjinore që lidhen me sigurinë kibernetike dhe teknologjinë. Disa prej tyre rekomandohet të përfshihen dhe integrohen edhe në objektivat e tjera të Strategjisë, sipas sugjerimeve më poshtë:</p>	<p>Organizata e OKB-së mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women)</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Reflektuar masat që lidhen vetëm me sigurinë kibernetike (Akses dhe përdorim jo i barabartë i teknologjisë digjitale) në Politikën 2. Mbrojtja online e qytetareve dhe nxitja e kulturës kibernetike. Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun digjital të punës reflektuar në Politikën 2. Mbrojtja online e qytetareve dhe nxitja e kulturës kibernetike dhe Qëllimi i politikës 4: Nxitja e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor</p>

	<p>Akses dhe përdorim jo i barabartë i teknologjisë digjitale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryerja e studimeve të cilat ofrojnë një analizë të thelluar të hendeqeve gjinore (për shembull të dallimeve gjinore në aftësitë digjitale, arsim dhe punësim në STEM/TIK, përdorimi dhe aksesimi në teknologji i popullsisë sipas karakteristikave kryesore si: mosha, niveli arsimor, vendbanimi, aftësia e kufizuar, etj.)</li> <li>- Mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit dhe e statistikave gjinore të sakta, në sektorin TIK</li> <li>- Zbatimi i masave të posaçme për eliminimin e hendekut gjinor në aftësitë digjitale, për t'iu përgjigjur mungesave të fuqisë punëtore në tregun përkatës të punës dhe për të reduktuar pabarazitë sociale dhe ekonomike</li> <li>- Hartimi i politikave që fokusohen posaçërisht tek dallimet gjinore në</li> </ul>			<p>Pjesa tjetër aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike në</p> <p>Objektivi specifik 1: Hartimi dhe zhvillimi i Planit Kombëtar për Ndërgjegjësimin e Qytetarëve (PKNQ);</p> <p>Objektivi specifik 2: Hartimi i një kornize ligjore për qasjen gjithëpërfshirëse të qytetarëve; Objektivi specifik 3: Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për mbrojtjen online të fëmijëve;</p> <p>Objektivi Specifik 4. Nxitja e Barazisë Gjinore në Hapësirën Digjitale. Miratimi dhe zbatimi i Direktivës është reflektuar edhe një ndër masat specifike të kësaj Strategjisë, nën Objektivin 2.3 mbi barazinë gjinore dhe Objektivi specifik 1.1: Hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor për Sigurinë Kibernetike</p>
--	--	--	--	---

	<p>akses dhe përdorim të internetit dhe telefonave celularë</p> <p>Ndarja gjinore në fushat e studimit (STEM, TIK)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi në programe dhe nisma konkrete të BE-së, si STEM4youth dhe “STEM skills for a future-proof Europe”, përmes bashkëpunimit me sistemet arsimore kombëtare</li> <li>- Zbatimi i masave që i kushtohen posaçërisht krijimit të mjediseve mësimore me ndjeshmëri gjinore në fushat e STEM</li> <li>- Kryerja e studimeve të mëtejshme mbi modelet e të mësuarit në internet ose modelet hibride, parë nga këndvështrimi gjinor</li> <li>- Zbatimi në sektorin arsimor i masave të reformave për mbështetjen proaktive të aftësive të vajzave në sektorin TIK dhe për rritjen e numrit të vajzave të regjistruara në degët STEM</li> </ul>			
--	--	--	--	--

	<p>- Kurse për shtimin dhe forcimin e njohurive dhe aftësive digjitale të mësueseve/mësuesve, për të siguruar përdorimin efektiv të teknologjisë në shkolla</p> <p>Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun digjital të punës</p> <p>- Ofrimi i kurseve në internet ose përmes materialeve në video për rritjen e aftësive, për t'i ndihmuar gratë t'i përdorin më mirë pajisjet digjitale dhe për të nxjerrë më shumë vlerë prej tyre</p> <p>- Kryerja e studimeve për të hulumtuar mospërputhjen e mundshme midis aftësive akademike të studenteve të diplomuara në fushat STEM dhe nevojave reale të tregut për punësim në fushën e teknologjise</p> <p>- Krijimi i programeve të posaçme për vajzat, për t'i mbështetur ato që të marrin pjesë në tregun e punës pas</p>			
--	--	--	--	--

	<p>diplomimit (tranzicioni shkollë-punë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunimi me sektorin privat për krijimin/sigurimin e një mjedisi pune me ndjeshmëri gjinore dhe që promovon talentet e grave</li> <li>- Nxitja e kompanive në sektorin digjital që të aderojnë në parimet për fuqizimin e grave.</li> <li>- Përdorimi i udhëzimeve për integrimin e parimeve të barazisë gjinore në procedurat e brendshme dhe në kulturën e vendit të punës në kompanitë e sektorit digjital</li> <li>- Shtimi i investimeve me ndjeshmëri gjinore në kompanitë e reja, përfshirë investimet për gratë</li> <li>- Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht e organizatave të rinisë dhe të grave, për të nxitur pjesëmarrjen e grave dhe të vajzave në ekonominë digjitale</li> </ul>			
--	--	--	--	--



	<p>Dhuna ndaj grave, bullizmi në internet, dhuna me bazë gjinore</p> <p>- Reformimi i kuadrit ligjor dhe i kodeve të sjelljes, që trajtojnë dhunën digjitale, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe zbatimi i legjislacionit që mbron gratë dhe vajzat nga të gjitha format e ngacmimit dhe të dhunës me bazë gjinore në internet</p> <p>Në vitin 2024</p> <p>Bashkimi Evropian miratoi një Direktivë në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Directive (EU) 2024/1385), të cilën edhe Shqipëria ka detyrimin t'a integrojë në legjislacionin e brendshëm, në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.</p> <p>Kjo Direktivë përmban një sërë dispozitash kundër dhunës kibernetike ndaj grave dhe vjazave të cilat mungojnë në legjislacionin shqiptar. Zyra e UN Women i ka paraqitur Ministrisë</p>			
--	---	--	--	--

	<p>së Drejtësisë një sërë sugjerimesh për përfshirjen e këtyre formave të dhunës në Kodin e ri Penal që pritet të miratohet. Miratimi dhe zbatimi i kësaj Direktive mund të jetë edhe një ndërj masat specifike të kësaj Strategjië, ose nën Objektivin 2.3 mbi barazinë gjinore ose Objektivin specifik 1.1: Hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor për Sigurinë Kibernetike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- punë e mëtejshme mbi programet ekzistuese kombëtare për sigurinë e fëmijëve, që në to të përfshihet qasja me ndjeshmëri gjinore</li> </ul> <p>Normat dhe stereotipet gjinore</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi i kodeve të sjelljes mbi gjuhën e urrejtjes në internet, që në to të përfshihet edhe dimensionin e dhunës me bazë gjinore</li> <li>- Promovimi i normave gjinore pozitive në internet dhe jashtë tij, për të mbështetur</li> </ul>			
--	---	--	--	--

	<p>pjesëmarrjen e plotë të vajzave dhe grave në hapësirat digjitale</p> <p>Mangësitë në statistika gjinore</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që prodhojnë të dhëna dhe INSTAT-it, me qëllim llogaritjen e treguesve gjinorë mbi digjitalizimin dhe sektorin TIK në Shqipëri, që janë të harmonizuar me treguesit e BE-së</li> <li>- Angazhimi në të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe monitorimin e treguesve gjinorë të harmonizuar me treguesit e BE-së, në sektorin e digjitalizimit dhe TIK në përputhje me metodologjinë e BE-së</li> <li>- Publikimi i rregullt i treguesve gjinorë në fushën e TIK të ndarë sipas karakteristikave të shumëfishta, në përputhje me kërkesat e BE/Eurostat</li> </ul>			
	<p><u>Treguesit Gjinorë</u></p>	<p>Organizata e OKB-së mbi</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Reflektuar vetëm masat që lidhen me sigurinë kibernetike,</p>

	<p>Plani i Veprimit të Strategjisë ka nevojë të plotësohet me tregues, që përkojnë me me rezultat dhe aktivitetet e parashikuara. (Kjo vlen për të gjithë Objektivat e Strategjisë). Më poshtë janë disa shembujsh treguesish në këtë fushë, që gjenden në Udhëzuesin e sipërcituar, bazuar në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së III 2021-2027(EU GAP III) dhe Objektivate të Zhvillimit të Qendrueshëm (SDGs):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i programeve qeveritare të zbatuara për rritjen e aftësisë së grave për të përfituar nga mundësitë e punësimit dhe sipërmarrjes, përfshirë të sipërmarrjeve sociale, të cilat krijohen në sajë të transformimit digjital</li> <li>- Numri i grave që përdorin shërbimet ose</li> </ul>	<p>Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women)</p>	<p>pra sugjerimet janë reflektuar në Qëllimi i politikës 4: Nxitja e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor, Objektivat Specifik 2,3, duke shprehur ‘Nxitjen e pjesëmarrjes së grave në sektorin TIK dhe në startup-e teknologjike me masa konkrete për mbështetjen e tyre në inovacion dhe biznes, përmes granteve dhe nismave të dedikuara’, por strategjia është për sigurinë kibernetike dhe nuk mund të parashikojmë gjithashtu edhe masa për plotësisht shërbimet, programet apo qendrat digjitale.</p>
--	---	--	--

	<p>programet e ofruara nga qendrat digjitale/parqet teknologjike, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i grave të emëruara në poste drejtuese të larta në teknologjinë digjitale</li> <li>- Përqindja e vajzave që kanë akses dhe përdorin mjetet e mësimin digjital nga distanca gjatë krizave, si gjatë krizës së shkaktuar nga Covid-19</li> <li>- Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve që marrin pjesë në hackathons digjitalë ose aktivitete të tjera për sipërmarrjet e reja digjitale, ndarë më së paku sipas seksit</li> <li>- Proporcioni i të rejave/rinjve dhe të rriturave/rriturve që kanë aftësi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (tiK), sipas llojit të aftësive (treguesi 4.4.1 i OZHQ) [e parashikuar ndarja sipas seksit]</li> <li>- Proporcioni i individëve që zotërojnë telefon</li> </ul>			
--	---	--	--	--

	celular, ndarë më së paku sipas seksit (treguesi 5.b.1 (OZHQ))			
	<p><u>Përputhshmëria me Dokumente Strategjike Ndërkombëtare</u></p> <p>Në vijim të sugjerimeve të mëparshme, vlerësohet me rëndësi që Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2025–2030 të jetë në përputhje me dokumentet strategjike ndërkombëtare, siç është EU Gender Equality Action Plan III (EU GAP III). Në veçanti, seksioni 3.6 i GAP III “Addressing the challenges and harnessing the opportunities offered by the green transition and the digital transformation” thekson rëndësinë e përfshirjes së grave dhe vajzave në transformimin digjital dhe në sektorin e</p>	<p>Organizata e OKB-së mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women)</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2025-2027 aktualisht janë në përputhje me dokumentet strategjike ndërkombëtare dhe ka në fokus të veçantë përfshirjen e grave dhe vajzave në sigurinë kibernetike dhe nxitjen e tyre të vazhdueshme të pjesëmarrjes së tyre në këtë sektor. Sugjerimet nga UN Women janë reflektuar në Objektivat Specifik 4.2 dhe 4.3</p>

	<p>inovacionit. Kjo përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimin e partneriteteve publike-private për të zvogëluar hendekun gjinor në kompanitë e mëdha teknologjike;</li> <li>- Nxitjen e pjesëmarrjes së grave në sektorin TIK dhe në startup-e teknologjike;</li> <li>- Promovimin e barazisë gjinore në politikat e inovacionit dhe kërkimit shkencor.</li> </ul> <p>Këto elemente mund të integrohen në Qëllimin e Politikës 4 të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivit Specifik 4.2: Mbështetja e startup-eve në fushën e sigurisë kibernetike;</li> <li>- Objektivit Specifik 4.3: Zhvillimi i programeve të financimit për kërkim dhe inovacion.</li> </ul>			
--	--	--	--	--

	<p><u>Përputhshmëria me Dokumente Strategjike Kombëtare</u></p> <p>Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2025–2030 duhet të harmonizohet me Strategjinë për Biznesin dhe Zhvillimin e Investimeve (BID 2015–2027), e cila është rishikuar në fillim të vitit 2025. Zhvillimi i SME-ve dhe Inovacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivi Specifik 2 i BID synon krijimin e një ekosistemi inovativ, dinamik dhe të qëndrueshëm për startup-et dhe bizneset.</li> <li>- Ky objektivi përfshin masa konkrete për mbështetjen e grave dhe vajzave në inovacion dhe biznes, përmes granteve dhe nismave të dedikuara. Ky objektivi lidhet drejtpërdrejt me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivin Specifik 4.2 të Strategjisë për Sigurinë</li> </ul> </li> </ul>	<p>Organizata e OKB-së mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women)</p>	<p>Pranuar Pjesërisht</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2025-2027 aktualisht janë në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare duke patur në fokus të veçantë përfshirjen e grave dhe vajzave në fushën e sigurisë kibernetike. Sugjerimet nga UN Women janë reflektuar në Objektivat Specifik 4.2 dhe 4.3.</p>
--	--	--	---------------------------	---



	<p>Kibernetike: Mbështetja e startup-eve në fushën e sigurisë kibernetike përmes aksesit në burime kërkimore dhe trajnime profesionale, duke nxitur krijimin e zgjidhjeve teknologjike inovative dhe fuqizimin e ekosistemit kombëtar të sigurisë kibernetike.</p> <p>Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor - Objektivi Specifik 3 i BID fokusohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, përmes programeve të arsimit profesional (VET) në fushat STEM, me synim rritjen e përfshirjes së grave dhe vajzave. Ky objektivi është i lidhur me: - Objektivin Specifik 4.3 të Strategjisë për Sigurinë Kibernetike: Zhvillimi i programeve të financimit për kërkim dhe inovacion, përmes</p>			
--	--	--	--	--

	krijimit të fondeve specifike, stimujve fiskalë dhe partneriteteve publike-private për bashkëfinancimin e projekteve inovative.			
<b>II. Krahasimi me vendet e rajonit dhe vendet e zhvilluara</b>	Të përcaktohen qartë treguesit kryesorë të performancës (KPI) dhe afatet operacionale, së bashku me një plan vjetor monitorimi.	ELTA	Refuzuar	Në Planin e Veprimit janë parashikuar masa konkrete dhe afate. Në zbatim të nenit 6, pika 1, të ligjit nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” AKSK është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.
	Të promovohet parimi i mbrojtjes aktive ( <i>Defend Forward</i> ) në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe rreziqet aktuale.	ELTA	Refuzuar	Aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike Qëllimi i politikës 1: Mbrojtja e Infrastrukturës Digjitale

	Të forcohen lidhjet me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, për përditësimin e strategjisë dhe integrimin me sistemet ndërkombëtare	ELTA	Refuzuar	Aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike, Politika 3. Forcimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar
	Të vijojë mbështetja për edukimin dhe trajnimin profesional, me fokus të veçantë fuqizimin e grave dhe grupeve të pambrojtura	ELTA	Refuzuar	Aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike Në Qëllimin e politikës 2: Mbrojtja online e qytetarëve dhe nxitja e kulturës kibernetike. Objektivi specifik 5: Krijimi i Mekanizmave të Nevojshëm për Mbrojtjen dhe Fuqizimin e Grupeve të Nënperfaqësuar

	Të themelohet një organ i pavarur mbikëqyrës për monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe publikimin e raporteve periodike.	ELTA	Refuzuar	AKSK ka në strukturë një sektor të dedikuar për monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planin e saj të Veprimit.
	Të krijohet një forum kombëtar për bashkëpunim me sektorin privat dhe institucionet financiare.	ELTA	Refuzuar	Parashikuar në politiken 4, objektivi specifik 1. Krijimi i Qendrës Kombëtare të Ekselencës për Sigurinë Kibernetike (QKESK) si një qendër inovative për kërkim dhe zhvillim teknologjik do të mundësojë bashkëpunimin e ngushtë mes akademisë, qendrave kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe institucioneve publike e private.
	Të formulohet një politikë për menaxhimin e rreziqeve të zinxhirit të furnizimit dhe për adoptimin e rregulloreve të avancuara mbi privatësinë	ELTA	Refuzuar	Parashikuar në politikën 1, objektivi specifik 1.3 Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve Kibernetike

	Të hartohet një plan kombëtar për menaxhimin dhe zëvendësimin e teknologjive të vjetruara, përfshirë hartëzimin, përcaktimin e prioriteteve dhe sigurimin e financimeve.	ELTA	Refuzuar	Aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike, Objektivi specifik 3.4: Menaxhimi efektiv i teknologjive të vjetruara.
	Të adoptohet parimi i Arkitekturës <i>Zero Trust</i> në të gjitha sistemet kombëtare kritike.	ELTA	Refuzuar	Aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike, Qëllimi i politikës 1: Mbrojtja e Infrastrukturës Digjitale, Teknologjia
	Të krijohet një njësi e posaçme <i>Cyber Command unit</i> , e cila do të bashkëpunojë me shërbimet inteligjente civile dhe organizatat ndërkombëtare.	ELTA	Refuzuar	Parashtrimi i bere bие nen fusheveprimin e strategjisë së sigurisë kombëtare. Një komandë e re është krijuar në Ministrinë e Mbrojtjes.

	Të rishikohet struktura organizative përgjegjëse për sigurinë kibernetike dhe të përshtatet me strategjinë, duke përfshirë ndarjen e përgjegjësive midis institucioneve shtetërore.	ELTA	Refuzuar	Aktualisht e përfshirë në dokumentet strategjike, Plani i Veprimit 2025-2027 i ka të specifikuar institucionet përgjegjëse/shpenzuese për çdo masë.
--	---	------	----------	---